

Në bazë të nenit 17 paragrafi (7) të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014, 199/2014 , 27/2016, 35/2018, 198/2018), dhe nenit 28 paragrafi (2) pika 5 dhe nenit 36 të Ligjit për kulturë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 15/2008, 116/2010, 47/2011, 51/2011, 136/2012, 23/2013, 44/2014, 61/2015, 154/2015, 39/2016, 11/2018 dhe 11/2018), drejtori i Institucionit Nacional Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, miratoi

## RREGULLORE

### **për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup**

#### **Neni 1**

Me këtë rregullore bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores nr. 02-248/3 nga data 09.09.2020 për sistematizimin e vendeve të punës në IN Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup dhe atë:

#### **Neni 2**

Neni 7 i Rregullores nr. 02-248/3 nga 09.09.2020 për sistematizimin e vendeve të punës në IN Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup ndryshohet si vijon:

Në këtë Rregullore janë përcaktuar dhe përshkruar gjithsej 25 realizues të vendeve të punës ofrues të shërbimeve, të sistemuar nëpër njësi organizative në pajtim me Rregulloren për organizim të brendshëm të IN Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut Shkup, nga të cilat janë plotësuar 22 realizues.

Vendet e punës ofrues të shërbimeve në pajtim me Ligjin për kulturë janë sistemuar në mënyrën në vijim:

Niveli	Realizues të sistematizuar	Vende të plotësuara të punës
D1	1	0
D2	8	6
D3	10	10
Gj1	1	1
G2	1	1
G3	4	4

Gjithsej	25	22
----------	----	----

### Neni 3

Në nenin 8 të Rregullores nr.02-248/3 nga 09.09.2020 për sistematizimin e vendeve të punës në IN Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup ndryshohet si vijon:

Në këtë Rregullore janë përcaktuar dhe përshkruar gjithsej 18 realizues të vendeve të punës persona ndihmës-teknik, të sistematizuar nëpër njësi organizative në pajtim me Rregulloren për organizim të brendshëm të IN Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, prej të cilave janë plotësuar 18 realizues.

Vendet e punës të personave ndihmës-teknik në pajtim me Ligjin për kulturë dhe Ligjin për të punësuarit në sektorin publik janë sistematizuar në mënyrën në vijim:

Niveli	Realizues të sistematizuar	Vende të plotësuara të punës
A1	1	0
B2	7	7
B1	10	10
Gjithsej	18	18

### Neni 4

Në pikën 3. Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin profesional për identifikim, mbrojtje, revitalizim, prezantim dhe popullarizim të trashëgimisë së luajtshme kulturore, në Seksionin për depo, dokumentim dhe konservim, vend pune me numër rendor 5 me emërtim Kustos i lartë, në Seksionin për depo, dokumentacion dhe konservim, me shifër KYJI 03 04 Д02 002, me titull Kustos i lartë, pjesa e numrit të realizuesve: numri 2 zëvendësohet me numrin 3.

### Neni 5

Në pikën 3. Pasqyra tabelore e vendeve të punës në Institucionin Nacional, Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, në Sektorin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, në Seksionin për çështje juridike, administrative, të përgjithshme teknike dhe financiare, vendi i punës me numër rendor 25 me emërtim Higjienist, me shifër KYJI 04 01 B02 005, me titull Punëtor tjetër për mirëmbajtje të objekteve, pjesa e numrit të realizuesve: numri 6 zëvendësohet me numrin 5.

### Neni 6

Në pajtim me ndryshimet në tekstin integral të Rregullores, bëhen ndryshimet dhe plotësimet edhe në Pasqyrën tabelore, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregullore.

### Neni 7

Kjo Rregullore hyn në fuqi me ditën e miratimit, ndërsa do të aplikohet pas pëlqimit të marrë me shkrim nga Bordi Drejtues i GN Galeria Nazionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Numri arkivor: 01-40/1

Data: 15.01.2021

Drejtor

Dr. Dita Starova Qerimi

### SHTOICË

#### 4. PASQYRA TABELORE E VENDEVE TË PUNËS

Nr. rend.	Shifra	Emërtimi u Titulli i vendit të punës	Numri i sistem. të vend. të pun.	Numri i vendeve të plotësuara		
				Nëpunës administrativ	Ofrues të shërbimeve	Ndihmës teknik
1	KYЛ 03 04 Д01 005	Udhëheqës i Sektorit – Udhëheqës i Njesisë së brendshme organizative – Sektori në bibliotekë/muze/Qendrën e Konservimit/kinotekë	1			
2	KYЛ 03 04 Д03002	Kustos në seksionin e ekspozitës – Kustos	3		3	
3	KYЛ 03 04 Д02002	Kustos i lartë në Seksionin e ekspozitës – Kustos i lartë	4		3	
4	KYЛ 03 04 Д03 002	Kustos në Seksionin për depo, dokumentacion dhe konservim-Kustos	2		2	
5	KYЛ 03 04 Д02002	Kustos i lartë në Seksionin për depo,	3		2	

		dokumentacion dhe konservim – Kustos i lartë				
6	KУЛ 03 04 Д03 003	Konservator - Konservator	1		1	
7	KУЛ 03 04 Д02 003	Konservator i lartë- Konservator i lartë	1		1	
8	KУЛ 03 04 Д03 007	Ciceron – Ciceron	1		1	
9	KУЛ 03 04 Д03 006	Edukator-Edukator	3		3	
10	KУЛ 03 04 Г01 005	Bibliotekar – Ndihmës i pavarur i bibliotekës	1		1	
11	KУЛ 03 04 Г02 005	Bashkëpunëtor magjistër i artit – Bashkëpunëtor profesional për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	1		1	
12	KУЛ 03 04 Г03 005	Bashkëpunëtor i artit – Bashkëpunëtor për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	2		2	
13	KУЛ 03 04 Г03 005	Bashkëpunëtor i artit – Bashkëpunëtor për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	1		1	
14	KУЛ 03 04 Г03 005	Dizajnues - Bashkëpunëtor për arte pamore, dizajn dhe arkitekturë	1		1	
15	KУЛ 0102 B02 001	Sekretar – Udhëheqës i Sektorit për çështje administrative, të përgjithshme dhe juridike	1	1		
16	KУЛ 01 02 B02 001	E fshirë	1			
17	KУЛ 04 01 A01 010	Teknik i muzeut – Teknik i muzeut	1			1

18	KYJL 0102 Г01 009	Marrëdhënie me publikun dhe marketing – Referent i pavarur për marketing dhe marrëdhënie me publikun	1	1		
19	KYJL 01 02 B04 010	Marrëdhënie me publikun dhe marketing – Bashkëpunëtor për marketing dhe marrëdhënie me publikun	1			
20	KYJL 01 02 Г01 001	Sekretar teknik – Referent i pavarur për çështje administrative	1	1		
21	KYJL 01 02 Г01 009	Arkivist ekonom – Arkivist	1	1		
22	KYJL 01 02 Г04 007	Ndihmës-arkivist – Referent i ri për evidencë kadrovike	1	1		
23	KYJL 04 01 B02 001	Mjeshtër universal - Mjeshtër universal	1			1
24	KYJL 0401 B02 004	Magaznier – Magaznier	1			1
25	KYJL 04 01 B02 005	Higjienist – Punëtor për mirëmbajtje të objekteve	5			5
26	KYJL 04 01 B01 004	Rojtar kontrollor – Punëtor për pranimin e vizitorëve	10			10
27	KYJL 01 02 B04 002	Kontabilist përgjegjës – Udhëheqës i seksionit për kontabilitet	1	1		
28	KYJL 01 02 Г01 004	Arkëtar – Referent i pavarur – kryearkëtar	1	1		
29	KYJL 01 02 B01 004	Bashkëpunëtor profesional për prokurime publike –	2	2		

		Këshilltar për punë financiare materiale				
	GJITHSEJ		54	9	22	18

Nr. ark. 01-40/2  
Data: 15.01.2021